



Pranuar / Dostigjen Primljeno / Prodato Received / Delivery	19.07.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr. Prot. Iti Prot. Prot. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKD/SHK	4203/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.514/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.514/2022 të datës 08.06.2022, të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi

Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 19.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.514/2022 e datës 08.06.2022 e parashtruar nga ankuesja

II. Obligohet Menaxheri i Personelit në Agjencinë e Punësimit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, ankueses për pozitën “Zyrtare e Lartë për Shërbime të Migracionit” t’ia ndryshoj Akt Emërimin duke ia përcaktuar koeficientin e pagës tetë (8), dhe te njëjtës t’i kompensohet diferenca e koeficientit të pagës duke filluar nga data 20.05.2022, gjegjësisht nga data e parashtrimit të kërkesës pranë Zyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës.

II. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Punësimit që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në pozitën e punës Zyrtare e Lartë për Shërbime të Migracionit në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, me datë 08.06.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 3330/2022 të regjistruar me numër A.nr.514/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër organit të punësimit *Agjencisë së Punësimit* lidhur me diskriminim në të ardhura (pagë), gjegjësisht mos harmonizim të koeficientit të pagës me përshkrimin e vendit të punës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot:3330/2022 të datës 08.06.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 20.05.2022 e parashtruar nga ankuesja për harmonizimin e koeficientit në akt emërim sipas përshkrimit të vendit të punës; Akt emërimin e ankueses me Nr.Prot.49 të datës 30.08.2017; Akt emërimin e ankueses me nr.1722 të datës 12.05.2014; Formularin për përshkrimin e detyrave të punës së ankueses; Kërkesën për përgjigjen në ankesë të datës 14.06.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 05.07.2022 nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Agjencia e Punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës; E-mailat zyrtar të datës 15.06.2022; Kontratën e marrëdhënies së punës së ankueses me numër 1722 e datës 01.06.2010; Listën e pagave për muajin mars, prill dhe maj të vitit 2022 për ankuesen; E-mailat zyrtar të datës 05.07.2022 dhe 06.07.2022; Akt emërimin Nr.293 të datës 15.06.2020 së bashku me formularin mbi përshkrimin e detyrave të punës; Akt emërimin Nr.268 të datës 30.11.2018 së bashku me formularin mbi përshkrimin e detyrave të punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi së ankesa e ankueses është pjesërisht e bazuar, SEPSE:

Nga administrimi i provave të lëndës, rezulton se ankuesja është e punësuar në pozitën e punës "Zyrtare e Lartë për Shërbime të Migracionit" në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës. Me datën 20.05.2022 ankuesja ka parashtruar kërkesën me numër protokollit 529 pranë organit të punësimit, lidhur me harmonizimin e koeficientit të pagës sipas përshkrimit të vendit të punës, mirëpo kërkesa e ankueses është refuzuar si e pa bazuar.

E pakënaqur me përgjigjen e organit të punësimit, e njëjta me datë 08.06.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se organi i punësimit është duke e diskriminuar në pagë, për shkak se realizon pagën me koeficient më të ulët se zyrtarët tjerë në pozita të nivelit të njëjtë në kuadër të organit të punësimit dhe kërkon që t'i harmonizohet koeficienti i pagës sipas përshkrimit të detyrave të punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore ka gjetur se ankuesja sipas Akt Emërimin Nr.Prot.49 të datës 30.08.2017 mban pozitën e punës "Zyrtare e Lartë për Shërbime të Migracionit", dhe e njëjta realizon koeficientin



e pagës shtatë pikë pesë (7.5), ndërsa brenda institucionit të njëjtë për pozitë të njëjtë "Zyrtar i Lartë" aplikohet koeficient i pagës tetë (8). Rrjedhimisht, nga administrimi i provave materiale është konstatuar se nëpunësi civil në pozitën e punës "Zyrtar i Lartë i Personelit" në Divizionin e Burimeve Njerëzore, dhe nëpunësi civil në pozitën e punës "Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa" në Divizionin për Buxhet dhe Financa, në të njëjtin institucion realizojnë koeficientin e pagës tetë (8).

Kolegji i Këshillit, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 19 ku përcaktohet se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave*, si dhe dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 3 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë*, dhe po ashtu dispozitat e Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, përkatësisht nenin 4 paragrafin 1 të të njëjtit ligj, përcaktohet se: *"Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin 1 të këtij Ligji"*, dhe rrjedhimisht duke marr parasysh se ankuesja sipas shkresave të lëndës është konstatuar se realizon koeficient të pagës shtatë pikë pesë (7.5), me të ulët se koeficienti i pagës për pozita të nivelit të njëjtë brenda organit të punësimit, vlerëson se në rrethanat e rastit konkret, ankuesja në kuptim të realizimit të të ardhurave personale është duke u trajtuar në mënyrë me pak të favorshme sesa nëpunësit tjerë civil brenda organit të punësimit të cilët mbajnë pozita të nivelit të njëjtë me pozitën të cilën e mban ankuesja, dhe në këtë mënyrë organi i punësimit është duke vepruar në kundërshtim me parimet e përgjithshme të menaxhimit të zyrtarëve publikë, përkatësisht nenin 7 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: *1. Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civile, me nëpunësit e Shërbimit Publikë dhe me nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet gjithashtu në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejte gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë*, kështu që pretendimi ankimor i ankueses për harmonizimin e koeficientit të pagës nga shtatë pikë pesë (7.5) në koeficientin tetë (8) është i drejtë dhe i ligjshëm.

Ndërsa, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses për njohjen e diferencës së pagës në mënyrë retroaktive që nga data 17.08.2017 si datë e nënshkrimit të Akt Emërimit Nr.Prot.49 të datës 30.08.2017, Kolegji i Këshillit konstaton se ky pretendim ankimor është i pa bazuar sepse nga shkresat e lëndës nuk është gjetur ndonjë dëshmi se ankuesja ka ndërmarrë veprime ligjore brenda afatit të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.


Andaj, bazuar në rrethanat si më lartë, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, është i obliguar të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative që ankueses t'ia ndryshoj aktin e emërimit duke ia përcaktuar koeficientin e pagës tetë (8), dhe të njëjta ti kompensohet në mënyrë retroaktive diferenca e koeficientit në

vlerë prej 0.5, duke filluar nga data 20.05.2022, gjegjësisht nga data e parashtrimit të kërkesës pranë Zyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda.A.nr.514/2022

Ardita Përguku-Shyti

Procesmbajtëse



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë e Punësimit;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Punësimit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.